



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
AGJENCIA E PARQEVË DHE REKREACIONIT

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHPENZIME PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE  
TË RËNDËSISË SË VEÇANTË”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
Medalje - 18512200-3, Lojra edukuese - 37524100-8, Trofe - 39298700-4

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**4,166,667 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10,

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; përkatësisht në vlerën: 83,333.34 (tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: "...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël..." dhe "...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhë..."

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.1.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/b dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

**Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse Autoriteti Kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm**

**për realizimin e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.**

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe Kreut II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

*Neni 43*

*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*

*Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.*

*2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

*c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;*

*3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;*

## **KREU II**

### **KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK**

*1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:*

*a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;*

*b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.*

*2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:*

*a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;*

*b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.*

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në prill të vitit 2026 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2026 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2025 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2023, 2024 dhe 2025.

**Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.**

**2.1.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

**2.1.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të maturuara ndaj shoqërisë “Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë” sh.a. (UKT).

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj UKT, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

## **2.2 Kapaciteti teknik:**

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një **vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit** të kësaj kontrate konkretisht: **833,333 (tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë pa tvsh**. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, germa (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

**2.2.2** Operatori Ekonomik me anë të një deklaratë të sigurojë kryerjen e transportit të të gjitha pajisjeve teknike dhe/ose personelit të nevojshëm në destinacionin ku do të zhvillohet aktiviteti, montimin, përdorimin dhe çmontimin e të gjitha pajisjeve teknike nga stafi i tij dhe largimin e tyre pas mbarimit të aktivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

*e Rregullave të Prokurimit Publik” nenin 41 pika 6 ku citohet: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe mbajnë përgjegjësi për kryerjen e shërbimit për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.*

**2.2.3** Operatori ekonomik me anë të një deklarate të sigurojë kryerjen e të gjitha detyrave specifike të mëposhtme që sigurojnë mbarëvajtjen e zhvillimit të aktiviteteve.

- a) Sigurimi i të gjithë stafit të nevojshëm (artistik dhe teknik) dhe angazhimi i tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit, në përputhje me programin e miratuar nga Autoriteti Kontraktor.
- b) Sigurimi i pajisjeve, materialeve dhe kostumeve të nevojshme për të gjitha performancat, duke përfshirë instrumentet muzikore, elementët skenikë, aksesoret artistikë dhe çdo pajisje tjetër funksionale të lidhur me realizimin e shërbimit.
- c) Koordinimi i plotë i stafit artistik (këngëtarë, aktorë, moderatorë, koreografë, animatorë, narratorë, ansamble, banda, trampolierë, skulptorë, etj.) me stafin teknik, për të garantuar rrjedhë të pandërprerë dhe cilësore të programit.
- d) Ndjekja e të gjitha provave paraprake, provave teknike dhe provës gjenerale, si dhe koordinimi i plotë sipas axhendës dhe skenarit artistik të miratuar.
- e) Realizimi i performancave sipas kohëzgjatjes, sekuencës dhe programit të përcaktuar, duke respektuar konceptin artistik dhe regjizorial të çdo aktiviteti.
- f) Sigurimi i standardeve të sigurisë për pjesëmarrësit, artistët dhe stafin, veçanërisht për performancat e zhvilluara në hapësira publike outdoor dhe për aktivitetet me fëmijë.
- g) Bashkëpunim i ngushtë me organizatorët e eventit dhe strukturat përkatëse të Autoritetit Kontraktor për respektimin e programit, skenarit dhe rregullave të përdorimit të hapësirave publike të administruara nga APR.
- h) Konceptimi dhe dorëzimi i skenarit artistik të plotë (për aktivitetet që e kërkojnë këtë), duke përfshirë strukturën e skenave, dialogjet dhe narracionin, në afatin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenin 41 pika 6 ku citohet: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe mbajnë përgjegjësi për kryerjen e shërbimit për përmbushje me suksese të kontratës objekt prokurimi.*

**2.2.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se është në përmbushje të detyrimeve për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga administrata tatimore për shlyerjen e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenin 41 pika 6 ku citohet: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe mbajnë përgjegjësi për kryerjen e shërbimit per permbushje me suksese te kontrates objekt prokurimi.*

**2.2.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të provojë me anë të një deklarate se disponon kapacitetet e nevojshme profesionale, stafin kryesor artistik dhe teknik për realizimin e objektit të kontratës te renditur si mëposhtë:

- |                      |              |
|----------------------|--------------|
| - Regjisor           | - Këngëtarë  |
| - Skenarist          | - Bandë live |
| - Aktorë             | - DJ         |
| - Narrator           | - Animatorë  |
| - Ansambël folklorik | - Moderator  |

Autoriteti kontraktor vendos kritere për kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilat lidhen dhe janë proporcionale me objektin e kontratës, duke përfshirë kapacitetin teknik dhe profesional.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenin 41 pika 6 ku citohet: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe mbajnë përgjegjësi për kryerjen e shërbimit per permbushje me suksese te kontrates objekt prokurimi.*

## **Specifikimet teknike**

### **AKTIVITETI 1**

#### **1. Formacion Orkestror harqesh**

- Sigurimi i interpretimit live të veprës "Katër Stinët" të A.Vivaldi nga formacion harqesh profesional (përzgjedhje/variant 60 min).

- Formacion Orkestror harqesh e përbërë nga minimumi 6 orkestrantë me karrierë ose të rinj, për interpretim muzikor live gjatë aktivitetit artistik, në përputhje me konceptin artistik dhe programin e përcaktuar nga organizatori. Interpretimi i *Katër Stinëve* të Vivaldi kërkon minimalisht 6 orkestrantë harqesh për të garantuar ekuilibrin e plotë harmonik ndërmjet zërave, ashtu siç e parashikon vetë kompozimi. Amfiteatri, si hapësirë e hapur me kapacitet të lartë audience, kërkon këtë formacion minimal për të siguruar projeksion akustik të mjaftueshëm dhe cilësi interpretative në nivel të duhur publik.
- Repertori muzikor të përshtatet me konceptin artistik të aktivitetit.
- Muzikantët duhet të marrin pjesë në provat muzikore dhe provën gjenerale para aktivitetit.
- Çdo muzikant siguron instrumentin e tij dhe aksesoret përkatës (harqe, mbajtëse partiturash, etj.).
- Formacioni duhet të jetë i gatshëm për koordinim me elementët e tjerë artistikë të shfaqjes (balet, narracion, skenografi).
- Të prezantojnë një CV të formimit profesional dhe eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

## **2. Koreograf**

- Duhet të realizojë shërbimin e koreografisë artistike për realizimin e performancës skenike të aktivitetit, me kohëzgjatje deri në 60 minuta, në përputhje me konceptin artistik të programit që bazohet në interpretimin e pjesëve të zgjedhura nga cikli muzikor "Katër Stinët" të kompozitorit Antonio Vivaldi. Duhet të hartojë lëvizje që pasqyrojnë ndjeshmërinë e secilës stinë, duke përdorur dinamikën e trupit për të shprehur ndryshimet e natyrës, intensitetin dhe emocionet që secila stinë sjell.
- Shërbimi përfshin konceptimin, realizimin dhe koordinimin e lëvizjeve koreografike të trupës së baletit dhe artistëve pjesëmarrës gjatë gjithë programit artistik, që përfaqëson 4 stinët.
- Drejton provat me trupën e baletit për përgatitjen e performancës, provat teknike dhe provën gjenerale para zhvillimit të aktivitetit.
- Të ketë formim akademik në fushën e baletit ose të koreografisë si dhe eksperiencë profesionale në krijimin dhe drejtimin e koreografive për performanca skenike.
- Të prezantojë një CV të formimit profesional dhe eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

## **3. Trupë baleti**

- Trupë baleti e përbërë nga minimumi 9 artistë me formim akademik ose profesional në fushën e baletit klasik ose bashkëkohor. Hapësira e skenës së amfiteatrit, si ambient i hapur me dimensione të konsiderueshme, kërkon këtë numër minimal artistësh për të mbuluar sipërfaqen skenike dhe për të siguruar një performancë të plotë e cilësore në nivel publik.
- Eksperiencë në performanca skenike live, evente kulturore ose aktivitete publike artistike.

- Aftësi për të interpretuar koreografinë e përcaktuar nga koreografi i aktivitetit, në përputhje me konceptin artistik të programit bazuar në ciklin muzikor "Katër Stinët" të A. Vivaldi.
- Gatishmëri për pjesëmarrje në të gjitha provat artistike, provat teknike dhe provën gjenerale para zhvillimit të aktivitetit.
- Koordinim me koreografin, orkestrën dhe elementët e tjerë artistikë të shfaqjes (narracion, skenografi).
- Artistët duhet të sigurojnë kostumet e nevojshme në përputhje me konceptin artistik dhe tematikën e aktivitetit (4 stinët).
- Të prezantojnë një CV të formimit profesional dhe eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

#### **4. Narrator**

- Të realizojë interpretimin narrativ gjatë programit artistik, duke lidhur pjesët muzikore dhe performancën koreografike të aktivitetit.
- Ai do të shërbejë si një udhërrëfyes që do të na çojë në një udhëtim magjik përmes katër stinëve, duke krijuar një lidhje të ngushtë mes muzikës, koreografisë dhe konceptit tematik të aktivitetit. Me fjalët e tij, ai do të ndërthurë tingujt e "Katër Stinëve" të Vivaldit me ndryshimet e natyrës, dhe do të na ndihmojë të përjetojmë thellësisht çdo stinë, siç ajo reflektohet në muzikalitetin dhe lëvizjet artistike.
- Të marrë pjesë në provat artistike dhe provën gjenerale.
- Të ketë eksperiencë në interpretim artistik, aktrim, recitim ose prezantim publik.
- Të prezantojë një CV të formimit profesional dhe eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

#### **5. Skenograf**

- Duhet të ofrojë shërbimin e konceptimit dhe realizimit të një skenografie minimale, të përshtatshme për një hapësirë të tipit amfiteatër, në funksion të konceptit artistik të aktivitetit me tematikë mbështetur në interpretimin e pjesëve nga cikli muzikor "Katër Stinët" i kompozitorit Antonio Vivaldi. Skenografia duhet të shërbejë si element vizual mbështetës për performancën muzikore dhe koreografike, duke krijuar një ambient estetik që reflekton simbolikën e stinëve.
- Të realizojë konceptin vizual dhe zbatimin e skenografisë me elementë skenikë simbolikë për aktivitetin (p.sh. pëlhura, degë, ose elementë dekorativë me ngjyra tematike). Përmes këtyre elementëve vizualë, skenografia do të përforcojë përshtypjet dhe emocionet që do të shkaktohen nga interpretimi muzikor dhe koreografik, duke krijuar një eksperiencë të papërsëritshme për publikun.
- Të ketë diplomë universitare në skenografi ose arte pamore.
- Të prezantojë një CV të formimit profesional dhe eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

#### **6. Trampolierë**

- Numri prej minimumi 4 trampolierësh është i nevojshëm për realizimin e figurave akrobatike kolektive dhe elementëve sinkronë që karakterizojnë këtë disiplinë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e performancës. Hapësira e jashtme kërkon këtë formacion minimal për të siguruar dukshmërinë dhe impaktin vizual të duhur.
- Të ofrojë një performancë artistike akrobatike me trampolierë, me kostume baroke/veneciane të lidhura me 4 stinët e konceptuar për të përfaqësuar simbolikisht verën, vjeshtën, dimrin, pranverën, në përputhje me konceptin artistik të aktivitetit. Performanca e tyre ndodh përpara fillimit të shfaqjes, jo në skenën e Amfiteatrit, por përgjatë rrugës që të çon në Amfiteatër.
- Secili artist të përfaqësojë simbolikisht njërin nga katër stinët.
- Artistët trampolierë duhet të kenë eksperiencë në performanca akrobatike ose artistike në evente publike outdoor.
- Artistët duhet të sigurojnë kostumet që do të përdoren gjatë performancës artistike.
- Kohëzgjatja e performancës sipas programit të aktivitetit.

## **7. Artist skulptor**

- Grup i përbërë nga minimumi 3 artistë skulptorë me formim akademik ose profesional, për realizimin e demonstrimeve live të skulpturës gjatë aktivitetit artistik. Numri prej 3 skulptorësh është i nevojshëm për të ofruar diversitet teknikash dhe materialesh në të njëjtën kohë, duke mundësuar që publiku të ndërveprojë dhe të ndjekë njëkohësisht procese të ndryshme krijuese.
- Koncepton ose përzgjedh projektin artistik të skulpturës.
- Realizon performancën artistike live për rreth 1–2 orë.
- Siguron veglat dhe materialet e nevojshme për realizimin e skulpturës.
- Skulptura duhet të jetë estetike, e qëndrueshme dhe e sigurt për publikun, duke minimizuar çdo mundësi për rrezik gjatë aktivitetit.
- Të prezantojë një CV të formimit profesional dhe eksperiencave të mëparshme në realizimin e skulpturave dekorative.

## **8. Bandë muzikore live (përfshirë vokalist)**

- Formacioni i një bande muzikore live me vokalist është i nevojshëm për të garantuar një performancë të plotë muzikore duke siguruar angazhimin e drejtpërdrejtë të audiencës dhe rrit impaktin artistik të performancës në ambientin e hapur.
- Bandë muzikore profesioniste me eksperiencë në performanca live dhe evente publike.
- Përbërje: 1 vokalist kryesor dhe minimumi 2 instrumentistë profesionistë.
- Repertori i gjerë muzikor për evente kulturore dhe festive.
- 60–90 minuta performancë live, sipas programit të aktivitetit.
- Pjesëmarrje në provë teknike (soundcheck).
- Të prezantojë një CV të eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

## **9. Moderator**

- Moderator profesionist me eksperiencë në prezantimin e eventeve publike, kulturore ose artistike.

- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.
- Dikcion i qartë dhe gjuhë e përshtatshme për publikun e gjerë.
- Aftësi për të prezantuar artistët dhe segmentet e programit sipas skenarit të aktivitetit.
- Kohëzgjatja e angazhimit deri në 4 orë, sipas programit dhe skenarit të aktivitetit.
- Të prezantojë një CV të eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

## **AKTIVITETI 2**

### **1. Artistë shqiptarë të muzikës pop**

- Repertori i gjerë me këngë pop të njohura për publikun e gjerë.
- Eksperiencë e dokumentuar në performanca live dhe evente publike artistike.
- Aftësi për të përshtatur repertorin dhe stilin e interpretimit sipas natyrës së eventit dhe profilit të publikut.
- Interpretim live i këngëve të repertorit të artistit dhe këngëve të njohura të muzikës pop.
- Kohëzgjatja e angazhimit 40–60 minuta performancë live, sipas programit dhe kërkesave të aktivitetit.
- Pjesëmarrje në provë teknike (soundcheck) para fillimit të aktivitetit.

### **2. Këngëtarë të muzikës popullore**

- Repertori i gjerë me këngë popullore nga treva të ndryshme të Shqipërisë.
- Eksperiencë e dokumentuar në performanca live dhe evente publike kulturore apo festive.
- Ndërveprim me publikun për të ruajtur energjinë dhe përfshirjen e pjesëmarrësve gjatë aktivitetit.
- Kohëzgjatja e performancës 40–60 minuta performancë live (sipas programit dhe kërkesave të aktivitetit).
- Pjesëmarrje në provë teknike (soundcheck) para fillimit të aktivitetit.

### **3. Moderator**

- Moderator profesionist me eksperiencë në prezantimin e eventeve publike, kulturore ose artistike.
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.
- Dikcion i qartë dhe gjuhë e përshtatshme për publikun e gjerë.
- Aftësi për të prezantuar artistët dhe segmentet e programit sipas skenarit të aktivitetit.
- Kohëzgjatja e angazhimit deri në 4 orë, sipas programit dhe skenarit të aktivitetit.
- Të prezantojë një CV të eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

### **4. DJ**

- Repertori i gjerë muzikor me mundësi përzgjedhjeje dhe personalizimi sipas natyrës së eventit dhe profilit të publikut.
- Eksperiencë në ndërveprim me publikun dhe në krijimin e një atmosfere dinamike dhe festive gjatë aktivitetit.

- Aftësi teknike në përdorimin e pajisjeve profesionale DJ dhe në miksimin e muzikës live.
- Kohëzgjatja deri në 4 orë performancë, sipas programit dhe axhendës së aktivitetit.
- Të prezantojë një CV të eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

## **5. Shërbim Animatorësh**

Shërbimi duhet të ofrohet nga jo më pak se 4 animatorë profesionistë (Face Painting, Kllounë, Xhonglierë, Maskota) me eksperiencë në aktivitete argëtuese dhe rekreative për fëmijë.

- Animatorët duhet të organizojnë dhe realizojnë lojëra interaktive, kërcime, këngë dhe aktivitete argëtuese, duke krijuar një atmosferë festive dhe tërheqëse për fëmijët dhe familjet.
- Animatorët duhet të kenë aftësi komunikimi dhe ndërveprimi me publikun, veçanërisht me fëmijët.
- Duhet të kenë kostume dhe pajisje të përshtatshme për performancën.
- Koha e shërbimit: deri në 3 orë, në përputhje me programin e aktivitetit.
- Të prezantojë një CV të eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

### **Pikturim Fytyre (Face Painting)**

- Realizim i pikturave në fytyrë për fëmijët nga animatorë të specializuar.
- Materialet e përdorura duhet të jenë profesionale, hipoalergjike dhe të sigurta për lëkurën.

### **Kllounë**

- Animatorë të veshur si kllounë me kostume me ngjyra të gjalla dhe dizajn tërheqës për fëmijët.
- Duhet të realizojnë lojëra argëtuese, humor, ndërveprim dhe animim të fëmijëve gjatë aktivitetit.

### **Xhonglierë**

- Performues që realizojnë manipulime dhe truke me topa, shkopinj dhe unaza.
- Shfaqja duhet të jetë dinamike dhe e përshtatshme për publik familjar.

### **Maskota**

- Personazhe të animuara, figura të njohura për fëmijët, superheronj ose personazhe të tjera argëtuese.
- Maskotat duhet të ndërveprojnë me fëmijët, të realizojnë fotografi dhe të marrin pjesë në lojëra dhe aktivitete argëtuese.

## **AKTIVITETI 3**

### **1. Regjizor**

- Të ketë formim në fushën e regjisë teatrore ose arteve skenike.

- Të ketë eksperiencë në realizimin e shfaqjeve teatrore, performancave artistike ose eventeve kulturore.
- Aftësi për të krijuar një strukturë dramaturgjike të qartë, që ndërthur interpretimin teatror, narracionin historik dhe elementët muzikorë.
- Aftësi për të realizuar një vënie skenike dinamike në hapësirë të hapur (outdoor).
- Hartimi i konceptit artistik dhe regjizorial të shfaqjes.
- Strukturimi i skenave që pasqyrojnë momentet historike kryesore:
  - Shpallja e Pavarësisë më 28 Nëntor
  - Çlirimi i vendit më 29 Nëntor
- Koordinimi me stafin teknik për ndriçimin, zërin dhe organizimin e hapësirës skenike.
- Mbikëqyrja e provave artistike dhe realizimi i shfaqjes sipas regjisë.
- Përgatitja artistike dhe zhvillimi i provave 3–4 javë para aktivitetit.
- Shfaqje artistike me kohëzgjatje 45–60 minuta, sipas konceptit regjizorial dhe programit të aktivitetit.
- Të prezantojë një CV të eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

## **2. Aktorë**

- Aktorë me eksperiencë në interpretim teatral dhe performanca artistike.
- Dikson i qartë dhe aftësi për interpretim emocional në përcjelljen e mesazheve historike.
- Gatishmëri për pjesëmarrje në provat artistike dhe për respektimin e skenarit dhe konceptit regjizorial.
- Interpretimi i skenave që risjellin momentet historike të rëndësishme të historisë shqiptare.
- Interpretimi i personazheve historike dhe figurave simbolike të kohës.
- Veshje/kostume të përshtatshme për tematikën e aktivitetit.
- Të prezantojë një CV të eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

## **3. Narrator**

- Person me eksperiencë në interpretim narrativ, prezantim skenik ose aktrim.
- Prezantimi i kontekstit historik të skenave të dramatizuara.
- Lidhja dramaturgjike e segmenteve të ndryshme të shfaqjes përmes narracionit.
- Përcjellja e informacionit historik të lidhur me momentet kryesore.
- Mbështetja e rrjedhës artistike të shfaqjes përmes një narracioni të qartë dhe emocional.
- Pjesëmarrje në provat artistike sipas programit të përcaktuar nga regjisori.
- Interpretim gjatë shfaqjes sipas skenarit dhe konceptit regjizorial.
- Veshje/kostum të përshtatshëm për tematikën e aktivitetit.

## **4. Skenarist**

- Skenarist ose autor me formim në dramaturgji, letërsi, arte skenike ose fusha të ngjashme.
- Njohuri të mira mbi historinë shqiptare, veçanërisht mbi momentet historike të lidhura me Festat e Nëntorit.
- Aftësi për të integruar në skenar dialogë teatralë, narracion historik dhe elementë simbolikë artistikë.
- Hartimi i skenarit artistik për dramatizimin e momenteve historike të lidhura me:
  - 28 Nëntor – Shpallja e Pavarësisë në Vlorë
  - 29 Nëntor – Çlirimi i vendit
- Struktura e skenarit duhet të përfshijë dialogë, narracion historik dhe skena simbolike, të përshtatshme për interpretim teatral.
- Përshtatja e skenarit për shfaqje në hapësirë të hapur (outdoor) dhe për publik të gjerë.
- Dorëzimi i një skenari të plotë artistik, që përfshin strukturën e skenave, dialogjet dhe narracionin.
- Skenari duhet të jetë i përshtatshëm për një shfaqje me kohëzgjatje 45–60 minuta, sipas konceptit artistik të aktivitetit.

## **5. Ansambël Folklorik**

- Ansambël folklorik profesionist me eksperiencë në interpretimin e këngëve dhe valleve popullore shqiptare.
- Përbërje me valltarë dhe muzikantë, të aftë të interpretojnë me instrumente tradicionale shqiptare (lahutë, çifteli, dajre, fyell, etj.).
- Posedim i kostumeve tradicionale të trevave të ndryshme të Shqipërisë.
- Eksperiencë në pjesëmarrje në evente publike, festivale folklorike ose aktivitete kulturore.
- Kohëzgjatja 40–60 minuta performancë live, sipas programit të aktivitetit.
- Pjesëmarrje në provë teknike (soundcheck) dhe koordinim me stafin teknik para fillimit të aktivitetit.
- Të prezantojë një CV të eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

## **6. Bandë muzikore live (përfshirë vokalist)**

- Formacioni i një bande muzikore live me vokalist është i nevojshëm për të garantuar një performancë të plotë muzikore duke siguruar angazhimin e drejtpërdrejtë të audiencës dhe rrit impaktin artistik të performancës në ambientin e hapur.
- Bandë muzikore profesioniste me eksperiencë në performanca live dhe evente publike.
- Përbërje: 1 vokalist kryesor dhe minimumi 2 instrumentistë profesionistë.
- Repertori i gjerë muzikor për evente kulturore dhe festive.
- 60–90 minuta performancë live, sipas programit të aktivitetit.
- Pjesëmarrje në provë teknike (soundcheck).
- Të prezantojë një CV të eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

## **AKTIVITETI 4**

### **1. Performancë interaktive**

- Artistë profesionistë (këngëtar: 1 person) me stil interpretimi: jazz, swing, muzikë e lehtë pop.
- Repertori i gjerë me këngë me tematikë të Krishtlindjes dhe Festave të Fundvitit për të realizuar program me kohëzgjatje deri 90 min.
- Eksperiencë e dokumentuar në performanca live dhe evente publike artistike.
- Aftësi për të ndërvepruar me publikun dhe për të mbajtur energjinë e lartë gjatë performancës, duke përshtatur repertorin dhe stilin e interpretimit sipas natyrës së eventit dhe profilit të publikut.
- Koordinim dhe bashkëpunim me stafin teknik të aktivitetit.
- Tre çifte balerinësh/performues (gjithsej 6 persona) të cilët do të kryejnë koreografi të shkurtër dhe të përshtatura për ndërveprim me publikun. Tre çiftet janë të nevojshme për të krijuar koreografi të sinkronizuara me muzikën live, duke mundur ndërveprim dinamik me publikun nga pika të ndryshme të hapësirës.
- Koreografi e thjeshtë, vizualisht efektive dhe e përshtatshme për turmë.
- Veshje/kostume të përshtatshme për tematikën e aktivitetit.
- Kohëzgjatja 20–30 minuta për balerinët performues.

### **2. Bandë muzikore live (përfshirë vokalist)**

- Formacioni i një bande muzikore live me vokalist është i nevojshëm për të garantuar një performancë të plotë muzikore duke siguruar angazhimin e drejtpërdrejtë të audiencës dhe rrit impaktin artistik të performancës në ambientin e hapur.
- Bandë muzikore profesioniste me eksperiencë në performanca live dhe evente publike.
- Përbërje: minimumi 2 instrumentistë.
- Repertori i gjerë muzikor për evente kulturore dhe festive.
- Kohëzgjatje deri 90 minuta performancë live, sipas programit të aktivitetit.
- Pjesëmarrje në provë teknike (soundcheck).
- Të prezantojë një CV të aktivitetit të tyre artistik.

### **3. Moderator**

- Moderator profesionist me eksperiencë në prezantimin e eventeve publike, kulturore ose artistike.
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.
- Diksoni i qartë dhe gjuhë e përshtatshme për publikun e gjerë.
- Aftësi për të krijuar ndërveprim me publikun dhe për të mbajtur atmosferë dinamike gjatë eventit.
- Aftësi për të prezantuar artistët dhe segmentet e programit sipas skenarit të aktivitetit.
- Kohëzgjatja e angazhimit deri në 4 orë, sipas programit dhe skenarit të aktivitetit.
- Veshje/kostume të përshtatshme për tematikën e aktivitetit.
- Të prezantojë një CV të eksperiencave të mëparshme në këtë fushë.

#### 4. Artistë statuja performuese

- Artistë/performues: 6 persona, të trajnuar për performanca statike dhe lëvizje të kontrolluara. Ambient i hapur me audience të lëvizshme dhe të shpërndarë kërkon këtë numër minimal performuesish për të garantuar praninë artistike të vazhdueshme në të gjithë zonën e aktivitetit dhe për të mundësuar ndërveprim të njëkohshëm me grupe të ndryshme të publikut, pa lënë zona të zbrazëta nga pikëpamja estetike dhe skenike.
- Roli i artistëve: Të qëndrojnë si statuja performuese në pozicione artistike të parapërcaktuara, të lëvizin ngadalë kur kërkohet dhe të ndërveprojnë me publikun në mënyrë të lehtë, pa prishur konceptin estetik.
- Kohëzgjatja e performancës 30–60 minuta në ambiente të hapura.
- Eksperiencë e dokumentuar në performanca itinerante, statura performuese ose teatër skenik.
- Prezencë skenike dhe aftësi për të qëndruar gjatë në pozicione statike me kontroll të mirë të trupit.
- Aftësi për të përshtatur performancën në varësi të hapësirës dhe turmës.
- Kostumet të sigurohen nga artistët, të dizajnuara sipas temës:
  - Ngjyra bazë: e bardhë.
  - Materiali: tekstile të lehta, të qëndrueshme, që mundësojnë lëvizje të kontrolluar dhe qëndrueshmëri gjatë performancës statike.

**Shënim:** Në të gjitha rastet kur është përmendur emri ose markë, njihet barazvleshmëria ose ekuivalent.